



Biblioteka Kombëtare e Kosovës  
“Pjetër Bogdani”



Kolegji Biznesi  
Prishtinë

### **Marrëveshje bashkëpunimi**

ndërmjet

**Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”**

dhe

**Kolegji Biznesi – Prishtinë**

Dy titullarët, Mr. Fazli Gajraku në cilësinë e Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” dhe Prof. Dr. Shyqeri Kabashi në cilësinë e Dekanit të Kolegji Biznesi në Prishtinë, duke u nisur nga vullneti për t'i forcuar dhe thelluar marrëdhëniet nëpërmjet tyre si partnerë, këtu të quajtur palë, bien dakord që të rrisin bashkëpunimin për nxitjen e shkëmbimeve të shumanshme në funksion të zhvillimit ndër-institucional.

#### **Neni 1**

Palët do të bashkëndihmojnë në grumbullimin, pasurimin, ruajtjen, mirëmbajtjen e trashëgimisë kombëtare të shkruar dhe të jo-shkruar, si dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare.

#### **Neni 2**

Palët do të ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e shkëmbimit të botimeve të tyre institucionale bibliografike dhe/ose shkencore.

#### **Neni 3**

Palët do të ushtrojnë ndaj njëra tjetrës të drejtën e shkëmbimit të informacionit bibliografik dhe albanologjik.

#### **Neni 4**

Palët do të bashkëpunojnë në organizimin e konferencave, seminareve, ekspozitave, panaireve, promovimeve të botimeve të rëndësishme të autorëve dhe/ose studiuesve shqiptarë apo të huaj, veprimtarive të përbashkëta kulturore/shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, si:

- nga fusha akademike me interes të përbashkët;
- nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese/kërkimore;
- pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në projekte të përbashkëta (me kërkesa të vecanta);
- shfrytëzimin e resurseve të institacioneve (me kërkesa të vecanta);
- trajnime profesionale për zhvillimin dhe menaxhimin e bibliotekës (me kërkesa të vecanta).

### Neni 5

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" mundëson anëtarësimin e të gjithë studentëve dhe mësimdhënësve të Kolegjit Biznesi, si lexues të rregullt, në harmoni me vendimin e BKK-së për anëtarësim të lexuesve. Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" u ofron shërbim të referencave për studentët dhe stafin akademik të Kolegjit Biznesi, duke përfshirë këtu informacionin për koleksionet (qasje në mbi 700 mijë tituj), katalogun elektronik dhe manual, mënyrat e hulumtimit, mënyrat e huazimit, si dhe orientimin e përdoruesve te personeli përkatës i Bibliotekës.

### Neni 6

Palët bien dakord që realizimi i veprimitarive të kryhet në varësi të burimeve dhe të potencialit të disponueshëm nga secili institucion dhe me marrëveshje specifike.

### Neni 7

Çdo nen i kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të palëve.

### Neni 8

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare nga data e nënshkrimit. Marrëveshja rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, kur të dy janë dakord për këtë.

Mosrinovimi i kësaj marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpëra përfundimit të saj.

### Neni 9


Marrëveshja hyn në fuqi menjëherë.

Nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

*Për dhe në emër të*

Bibliotekës Kombëtare të Kosovës  
"Pjetër Bogdani"

Drejtori  
Fazli Gajraku



*Për dhe në emër të*

Kolegji Biznesi  
Prishtinë



Prishtinë,  
më 15 maj 2019